MENAXHIMI I CIKLIT TE PROJEKTIT

(me fokus në bashkëpunimin ndërvendor)

Një manual për Njësitë e Qeverisjes Vendore

2013

Ky publikim është përgatitur nga Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp), me mbështetjen financiare të Agjencisë Zvicerrane për Zhvillim dhe Bashkëpunim

Përgatitur nga:
Vera Xhokaxhi (PhD) dhe Myftar Doçi (MPA)
Qendra Kombëtare Burimore e Trajnimit dhe Asistencës Teknike (ANTTARC)

Mbështetur nga:
Valbona Karakaçi
Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)
HELVETAS Sëiss Intercooperation, Shkodër, Albania

Ky publikim reflekton mendimet e autorëve dhe jo detyrimisht të SDC.

Publikuar nga:
Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)
HELVETAS Sëiss Intercooperation (HSI) Albania

Copyright © HSI Albania
Rr. Oso Kuka, Nr. 11,
4000 Shkodër, Albania
ëëë.dldp.al

PARATHËNIE

Ky manual përshkruan çështjet e zhvillimit dhe të zbatimit të projektit bazuar në metodën e kuadrit logjik dhe është dizenjuar për të ndihmuar ekipet e menaxhimit të projekteve pranë Njësive të Qeverisjes Vendore (NJQV) përgjatë gjithë fazave kyçe, duke filluar nga ideja e parë deri në vlerësimin përfundimtar të projektit dhe raportimin mbi realizimin e tij.

Manuali përmban qëllimin dhe konceptet bazë lidhur me secilën fazë të menaxhimit të ciklit të projektit si dhe dokumentet dhe vendimet kyçe përkatëse përfshirë fazën e planifikimit dhe hapat për analizën e palëve të interesuara, hartimin e pemës së problemeve dhe të objektivave, hartimin e matricës logjike, dokumentit të projektit si dhe planit të detajuar të aktiviteteve.

Specifike në këtë manual është ilustrimi i tij me një projekt konkret ndërvendor të realizuar në kuadrin e dldp--Programi i Decentralizimit dhe Zhvillimit Lokal. Projekti është hartuar dhe zbatuar nga tre NJQV të Qarkut Shkodër--bashkia Pukë dhe komunat Qerret e Rrape--me synim sigurimin e një shërbimi më cilësor dhe me kosto më të ulët për komunitetet e tyre. Në këtë këndvështrim manuali ofron disa mekanizma konkrete menaxhues dhe ligjore të nevojshme për të realizuar projektet ndërvendore, të cilat mund të jenë të përdorshme nga NJQV të tjera në raste të ngjashme.

Ky manual është një mjet për të patur sukses në përpjekjet e NJQV për plotësimin e nevojave të komunitetit. Por vlefshmëria e tij varet shumë nga mënyra se si ai aplikohet në punën e përditshme të drejtuesve dhe stafit të NjQV-ve.

Manuali është përgatitur nga Qendra Kombëtare Burimore e Trajnimit dhe Asistencës Teknike (ANTTARC), në kuadrin e Programit të Decentralizimit dhe Zhvillimit Lokal (dldp). Për zhvillimin e këtij manuali, ANTTARC është mbështetur në materialet e ndryshme burimore për menaxhimin e ciklit të projektit dhe bashkëpunimin ndërvendor si dhe eksperiencën e tij në zhvillimin e kapaciteteve të NJQV për hartimin dhe zbatimin e projekteve të financuara nga dldp.

ANTTARC, 2013

PËRMBAJTJA

Hyrje

Kuptimi i ciklit të projektit dhe Menaxhimit i Ciklit të Projektit në projektet ndërvendore

Karakteristikat kryesore të fazave të ciklit të projektit në bashkëpunimin ndër-vendor

Çfarë është planifikimi? Planifikimi i projekteve ndërvendore

Analiza e situatës në bashkëpunimin ndërvendor

Qëllimi i përgjithshëm i projektit

Alternativat

Strategjia/ndërhyrja e projektit

Dokumenti i projekteve ndërvendore

Plani i aktiviteteve (i detajuar)

Anekset

HYRJE

Mësimet e fituara nga zhvillimi dhe zbatimi i projekteve ndërvendore

Nga eksperienca, organizatat e ndryshme publike dhe jo publike, hasin një sërë problemesh dhe sfidash gjatë hartimit dhe zbatimit të projekteve, të cilat shërbejnë si mësime për të punuar më mirë në të ardhmen. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me NJQV, të cilat gjatë hartimit dhe zbatimit të projekteve kanë shfaqur disa dobësi të cilat duhen përmirësuar për në ardhmen. Ato përfshijnë:

- Njësitë e Qeverisjes Vendore nuk kanë njohuritë dhe aftësitë për të marrë vendimet e duhura në kohën e duhur lidhur me realizimin e fazave të ndryshme të Ciklit të Projektit.
- Objektivat specifike, të cilat duhet të përfshijnë përfitime të qendrueshme për komunitetin, nuk janë realiste dhe nuk përshkruhen qartë.
- Nuk bëhet qartë dallimi midis objektivave dhe mjeteve për arritjen e tyre;
- Hartimi i projektit dhe monitorimi i e aktiviteteve nuk janë parë në këndvështrimin e arritjes së treguesve të përfshirë në projekt dhe raportimit cilësor mbi zbatimin e tij.

Disa nga mësimet e nxjerra nga eksperienca përfshijne:

- Faza e planifikimit është themelore për të zhvilluar projekte cilësore dhe fituese. Në këtë kontekst, pjesëmarrja e palëve kryesore të interesuara duke përfshirë këtu jo vetëm përfaqësuesit e Njësive të Qeverisjes Vendore por edhe antarët e komunitetit, sidomos grupet e marxhinalizuara të tij, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe të sektorit privat është shumë e rëndësishme për zgjidhjen e nevojave dhe me ndikim afat-gjatë në komunitet.
- Qendrueshmëria e projektit dhe përfitimeve të tij si dhe fuqizimi i kapacitetit menaxhues të ekipeve përkatëse në

Njësitë e Qeverisjes Vendore janë ndër kushtet kryesore për zhvillimin e projekteve fituese dhe zbatimin me sukses të tyre.

- Projektet ndërvendore, ku dy ose më shumë Njësi të Qeverisjes Vendore bashkojnë burimet e tyre për të zgjidhur një nevojë të përbashkët në komunitetet e tyre, janë një ndër rrugët më efektive, efiçente, dhe rezultative. Janë një sërë nevojash në komunitet, të cilat janë të njëjta në Njësi Vendore të ndryshme dhe mund të zgjidhen më mirë nëpërmjet bashkëpunimit mes tyre. Këto Njësi Vendore mund t'i bashkojë vazhdimi territorial apo problemi i njejtë si dhe mundësia e vogël për t'i zgjidhur ato individualisht.

Bashkëpunimi ndërvendor si zgjidhje e qëndrueshme për ofrimin e shërbimit

NJQV-të të ndryshme për shërbime të caktuara, mund ta ndajnë ekspertizën ose burimet e tyre me NJQv të tjera për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe efektive. Madje në raste kur ka kërkesa ligjore për shërbime të tilla si menaxhimi i mbetjeve, furnizimi me ujë, zhvillimi i transportit dhe zhvillimi ekonomik ato mund të bashkëpunojnë mes tyre për të ofruar një shërbim me kosto të ulët.

NJQV-të kanë kompetenca jetike që përcaktojnë cilësinë e jetës së qytetarëve dhe mirëqenien e përbashkët të tyre. Ato përfshijnë ndërtimin e rrugëve dhe menaxhimin e trafikut, transportin, furnizimin me ujë, shkollat dhe kopshtet, qendrat shëndetësore, mjediset sportive, mbledhjen dhe largimin e mbeturinave, muzetë, teatrot dhe qendrat kulturore, varrezat, etj. Megjithatë, përvoja tregon se NJQV-të nuk janë kurrë plotësisht të vetëmjaftueshme pavarësisht nga madhësia e territorit të tyre dhe nga popullata që kanë. Territoret dhe popullata e NJQV-ve po bëhen gjithnjë e më tepër të ndërvarura. Bashkëpunimi ndërvendor në projekte të përbashkëta është zgjidhja e shumë situatave të ndryshme.

Bashkëpunimi ndërvendor është veçanërisht i rëndësishëm për vendin tonë sepse ajo siguron akses në një spektër të gjerë financimesh të jashtme.

Programe të ndryshme të mbështetura nga Bashkimi Evropian BE dhe donatorë të tjerë ndërkombëtarë kërkojnë ose (a) një prag minimal në lidhje me madhësinë e projektit (që është shumë i lartë për bashkitë më të vogla), ose (b) një aplikim të vetëm të dy ose më shumë bashkive.

Disa nga karakteristikat kryesore të bashkëpunimit ndërvendor janë:

- Në bashkëpunimin ndërvendor dy ose disa NJQV punojnë së bashku.
- Me anë të bashkëpunimit, bashkitë partnere pranojnë të punojnë së bashku me një kosto të caktuar për të krijuar përfitime të reja për gjithsecilën prej tyre, përfitime të cilat nuk do të ishin të mundshme po të veprohet në mënyrë të izoluar ose të njëanshme.
- Përpjekjet e përbashkëta mund të lidhen me një ose disa nga sferat që kanë të bëjnë me kompetencat ligjore të bashkive. Ligji mund të përcaktojë që disa prej kompetencave që u jepen bashkive nuk mund të realizohen me bashkëpunim ndërvendor. (p.sh. kompetencat e shtetit që i delegohen kryetarit të bashkisë).
- Bashkëpunimi ka një kosto për secilën bashki partnere: ky bashkëpunim duhet të shoqërohet nga përpjekje, kontribute financiare dhe akses i përbashkët në burime (staf, tokë, makineri, ndërtesa, etj.).
- Bashkëpunimi ndërvendor është rezultat i një vendimi të qëllimshëm dhe jo thjesht një zbatim mekanik i një dispozite ligjore. Marrëveshja, më shumë se sa e imponuar nga ligji, është e vullnetshme, ndonëse ndonjëherë ligji mund t'i nxisë në mënyrë të fuqishme ose edhe t'i detyrojë ato që të kërkojnë zgjidhje bashkëpunuese.

- Përfitimet e reja për bashkitë partnere mund të kenë karakteristika të ndryshme, si për shembull: krijimi i kapaciteteve për ofruar shërbime të cilat nuk mund të ofrohen nga një bashki e vogël, zvogëlimi i kostove për ofrimet e shërbimeve, përmirësimi i cilësisë së shërbimit, koordinim më i mirë në planin e zhvillimit, politika më të efektshme dhe më të dukshme.
- Bashkëpunimi nuk është rastësor; ai ka një kohëzgjatje të caktuar dhe është shpesh një marrëveshje e përhershme e cila nuk ka një datë të caktuar se kur përfundon.

Nuk ka kalim të përhershëm të detyrave dhe kompetencave vendore; bashkitë e ruajnë kontrollin jo të drejtpërdrejtë për vendimet dhe shërbimet që rrjedhin nga bashkëpunimi. [1]

1) Burimi: Manual i Instrumenteve: Bashkëpunimi Ndërbashkiak (përgatitur nga Këshilli i Evropës (CoE), Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), Iniciativa për Qeverisjen Lokale, dhe Shoqëria e Hapur. 2010.

KUPTIM I PËRGJITHSHEM MBI PROJEKTIN DHE MENAXHIMIN E CIKLIT TË PROJEKTIT

Projekti konsiston në një sërë aktivitetesh të koordinuara dhe të kontrolluara të cilat ndërmerren me një qëllim të caktuar, të cilat kanë kosto, burime dhe afate kohore të përcaktuara. Çdo projekt është specifik dhe në të reflektohet nevoja për ndryshim. Ndryshimet mund të lindin nga disa faktorë:

- nevoja për ti dhënë zgjidhje një problemi të komunitetit;
- reflektimi ndaj një momenti nevoje në organizatë;
- shfrytëzimi i mundësive të reja.

Projektet zakonisht realizohen nga një numër i kufizuar njerëzish, të cilët për një kohë të caktuar punojnë së bashku. Projekti në vetvete përfaqëson një mundësi për të forcuar lidershipin dhe punën në ekip pasi:

- individëve u jepen më shumë përgjegjësi se sa ato kanë në aktivitetin e përditshëm;
- njerëzit mësojnë t'i përshtaten më mirë njëri-tjetrit;
- konfliktet e ndryshme midis anëtarëve të ekipit zgjidhen gjatë zbatimit të projektit;
- anëtarët e grupit të projektit kanë mundësi të kualifikohen nga ana profesionale dhe të fitojnë aftësi të reja.
- grupi përfshihet në procesin e vendim marrjes.

Pra projektet kanë vlerë për të zhvilluar si individët ashtu edhe organizatën në përgjithësi. Fakti që një organizatë përfshihet në hartimin dhe zbatimin e projekteve tregon që ajo është në një stad të tillë zhvillimi ku individëve mund t'u besohen detyra që kërkojnë nivel të lartë profesionalizmi.

Projekti në vetevete përfaqëson një cikël që kalon në disa faza. Cikli i jetës së një projekti duhet të fillojë me vlerësimin e nevojave të komunitetit. Ekziston një sekuencë e kalimit nga një fazë në tjetrën, pra disa aktivitete siç janë vendosja e qëllimeve dhe objektivave, indikatorëve, hartimi i buxhetit, etj duhet të kryen përpara fillimit të fazës së zbatimit.

Kuptimi i ciklit të projektit dhe menaxhimi i tij

Cikli i projektit përmbledh fazat e ndryshme përmes të cilave realizohet një iniciativë duke filluar nga faza e identifikimit paraprak e deri në atë të vlerësimit të realizimit përfundimtar të saj. Menaxhimi i Ciklit të Projektit (MCP) është metoda që përdoret për përcaktimin në mënyrë të saktë të qëllimit, të aktiviteteve menaxhuese dhe procedurave vendimarrëse të çdo faze të projektit. Objektivat kryesore të MCP-së janë :

- Përcaktimi në mënyrë të qartë dhe realiste i objektivave të projekteve/ programeve.
- Sigurimi i një cilësie të lartë përgjatë gjithë ciklit të projektit (si p.sh. përzgjedhja e një teknologjie të përshtatshme, respektimi i vlerave social-kulturore, kapacitetet institucionale, qendrueshmëria, etj.).
- Sigurimi i një përputhshmërie dhe kontributi ndaj "objektivave afatgjata të strategjive/politikave".
- Realizimi i qëndrueshmërisë.
- Dokumentimi i ndryshimeve/mësimeve të nxjerra.

Disa nga konsiderata kryesore për MCP:

- Bërja transparente e vlerave institucionale dhe personale dhe e supozimeve bazë.
- Realizimi i të gjitha fazave të MCP-së në bashkëpunim të ngushtë me partnerët.
- Qartësimi i roleve dhe i përgjegjësive të partnerëve të ndryshëm.

- Mbështetja e partnerëve gjatë forcimit të njohurive dhe kapaciteteve për MCP.
- Përpunimi kolegjial dhe reflektimi i mësimeve të nxjerra gjatë zbatimit/ planifikimit, si një proces bashkëpunues.

KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË FAZAVE TË CIKLIT TË PROJEKTIT

Ndarja e ciklit të projektit në faza të veçanta, siç propozohet në këtë manual, bazohet mbi konsiderata praktike dhe didaktike. Ky model lejon diferencimin e qartë të detyrave, dokumenteve dhe vendimeve që duhen marrë për çdo hap të planifikimit dhe të zbatimit të projektit. Figura 1 paraqet fazat kryesore të menaxhimit të ciklit të projektit, vendimet kryesore dhe dokumentet perkatëse.

Kuadri strategjik

Çdo projekt apo program zhvillimi është i shoqëruar me një kuadër strategjik (plane strategjike zhvillimi kombëtare, plane strtegjike zhvillimi rajonale e lokale/plane strategjike, plane strategjike të donatorëve, etj.). Në përgjithësi, projektet dhe programet e reja duhet të integrohen në këtë kuadër për të rritur koherencën dhe sinergjinë e bashkëpunimit ndërmjet investimeve të ndryshme.

Projektet ndërvendore duhet të bazohen në kuadrin strategjik kombëtar dhe rajonal, planet ndërvendore, si dhe programet e ndihmës së huaj, të cilat gjithashtu reflektojnë prioritetet kombëare të vendit si dhe ato rajonale.

Identifikimi

Qëllimi i kësaj faze është sqarimi i idesë së projektit si dhe mbledhja e informacionit bazë (vlerësimi i situatës së përgjithshme). Rezultati i pritshëm i kësaj faze është sigurimi i një vendimi pozitiv për idenë e projektit të paraqitur, në mënyrë që të çelet "drita e gjelbër" për një vlerësim dhe planifikim të mëtejshëm. Produkti i fazës së identifikimit është një përmbledhje e idesë së projektit mbi të ardhmen e projektit ose alternativat e tij (dokument referimi për diskutim dhe negocijim të mëtejshëm) dhe një marrveshje paraprake për bashkëpunim.

Bashkëpunimi me Njësitë e tjera Vendore niset nga ideja se ka shërbime që NJQV të ndryshme nuk i ofrojnë për shkak të burimeve të pamjaftueshme financiare ose njerëzore. Bashkëpunimi ndërvendor qysh në këtë fazë është i rëndësishëm për suksesin e projekteve ndërvendore. Rezultati i pritshëm i kësaj faze është sigurimi i një vendimi pozitiv ndërvendor për idenë e projektit të paraqitur duke çelur "driten jeshile" për një vlerësim dhe planifikim të mëtejshëm. Produkti i fazës së identifikimit është përmbledhja e idesë së projektit dhe marrveshja paraprake për bashkëpunimin ndërvendor. Disa nga aktivitete kryesore janë: Organizimi i takimeve midis NJQV për mundësinë e bashkëpunimit; Identifikimi i mundësive të bashkëpunimit; Krijimi i grupit të punës ndërvendor me përfaqsuesit përkatës të NJQV-ve; Shqyrtimi i situatës lidhur me problemin që synon të zgjidhe ose shërbimin që synon të ofrojë projekti i bashkëpunimit ndërvendor; Identifikimi i bazës ligjore dhe marrëdhenjeve institucionale midis NJQVve; Hartimi i një marrëveshje paraprake bashkëpunimi ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.

Planifikimi

Duke u bazuar në përmbledhjen e idesë hartohet projekt propozimi i plotë. Detyra të rëndësishme për planifikimin e projektit janë:

- Analiza e aktorëve, e interesave dhe e roleve të tyre në projekt.
- Përcaktimi i objektivave, treguesve dhe supozimeve, në përgjithësi, për kuadrin logjik (i referuar gjithashtu si Matrica e projektit). Ky hap kërkon një planifikim të kujdesshëm dhe të detajuar me të gjithë aktorët e interesuar

(zakonisht në seminaret e planifikimit).

- Përpunimi dhe negocijimi i strukturës organizative, i mjeteve dhe i buxhetit të nevojshëm.
- Përcaktimi i elementeve për drejtimin dhe vlerësimin e projektit me synim zbatimin efektiv të tij. Drejtimi i projektit përfaqëson aspektin më të rëndësishëm të menaxhimit në fazën e realizimit duke përfshirë përcaktimin e afateve të monitorimit dhe vlerësimit dhe raportimit të projektit.

Produkti i fazës së planifikimit është dokumenti i projekt propozimit të plotë bashkë me marrëveshjen institucionale të bashkëpunimit. Ky dokument ndërtohet sipas së njëjtës strukturë si dhe përmbledhja e idesë së projektit

Figura 1: Menaxhimi i Ciklit të Projektit: Fazat, vendimet, dokumentet kryesore



Vlerësimi paraprak përfaqëson fazën finale të diskutimit të një projekti të ri. Ai përbën një vlerësim të procesit të planifikimit dhe të cilësisë së përgatitjes së dokumentit të projektit. Vlerësimi paraprak studion përputhshmërinë dhe përshtatshmërinë e projektit të propozuar dhe konsideron nëse procesi përgatitor ka qenë i kënaqshëm nga pikëpamja e analizës dhe e pjesëmarrjes. Vlerësimi paraprak mund të realizohet si një proces i pavarur, ose si një proces i brendshëm i kryer nga donatori.

Dokumenti i projektit duhet aprovuar (me shkrim) nga donatori dhe institucioni zbatues. Produkti i kësaj faze është një marrëveshje formale e projektit që cakton përgjegjësitë e aktorëve në lidhje me mjetet, financimet, monitorimin dhe procedimet e mëtejshme.

Duke u bazuar në përmbledhjen e idesë dhe marrveshjen paraprake midis NJQV-ve pjesëmarrëse, zhvillohet projekt propozimi i plotë. Këtu: Bëhet grumbullimi i të dhënave për shkrimin e projekt propozimit dhe analiza e aktorëve dhe rolit të tyre në projekt (theksi duhet vendosur tek aktorët e përfshirë—këshillat, administrata, etj.,--arësyet e këtij bashkëpunimi dhe strategjitë për arritjen e tij); Së bashku zhvillohen objektivat, treguesit dhe supozimet; Negociohet struktura organizative e projektit ndërvendor, mjeteve dhe buxhetit të nevojshëm; Përcaktohet si do të bëhet drejtimi dhe vlerësimi i projektit; dhe se fundi Aplikimi i përbashkët tek dldp dhe miratimi i bashkëfinancimit nga NJQV-të.

Në bashkëpunimin ndërvendor, NJQV pjesëmarrëse duhet të sigurojnë pjesëmarrjen e përfaqësuesve të tyre dhe të kërkojnë pjesëmarrjen nga të gjitha NJQV-të e përfshira në projekt në mënyrë që vendimmarrja të jetë gjithëpërfshirëse.

Zbatimi

Qëllimi i zbatimit të programit është krijimi i një sistemi efektiv të menaxhimit të projektit. Kjo nënkupton përshtatjen e vazhdueshme të planeve specifike të punës me kushtet e

ndryshueshme dhe kërkesat e aktorëve që përfshihen në projekt. Kjo nënkupton, gjithashtu, verifikimin e progresit të punës përmes një sistemi monitorimi të përzgjedhur mirë e që synon që vendimet respektive për ndryshim dhe adaptim të gjykohen të nevojshme për tu përfshirë në planet operacionale dhe ato specifike të punës.

Zbatimi i projektit përbën një proces dinamik dhe reciprok ndërmjet planifikimit dhe monitorimit. Menaxhimi i fazës së implementimit përfshin detyrat e mëposhtme:

- Përpunimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i planeve të punës, duke filluar nga njësia e menaxhimit të projektit, në bashkëpunim të ngushtë me ekipin e projektit dhe/ose partnerë të tjerë operacionalë.
- Koordinimi i proceseve vendimarrëse me synim fokusimin e progresit të punës drejt operacioneve realiste dhe/ose koordinimi i vendimeve strategjike që duhen ndërmarrë brenda strukturave drejtuese. Këto vendime merren nga aktorët kryesorë, ndërkohë që vendimet operacionale merren nga ekipi i projektit.
- Përpunimi i planeve operacionale vjetore që specifikojnë aktivitetete të veçanta, ndarjen e detyrave, mjeteve dhe hartimin e buxhetit për vitin e ardhshëm, bazuar në përvojat e vlerësimit dhe rezultatet e vitit paraardhës.
- Një raportim sistematik mbi progresin e punës sipas një plani të përcaktuar mirë për përgatitjen periodike të dokumenteve të projektit (si p.sh. raportet vjetore, 6 ose 3-mujore, raportet specifike teknike, ose financiare, etj.)

Produktet e fazës së zbatimit janë :

- Planet operacionale specifike (plani vjetor dhe, nëse kërkohen, planet afat-shkurtra të veprimit).
- Raportet e përgatitura sipas kërkesave operacionale dhe administrative respektive.

Pas miratimit të projektit, Njësitë Vendore pjesëmarrëse në projekt institucionalizojnë bashkëpunimin e tyre nëpërmjet një marrveshje bashkëpunimi ku përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë e tyre si dhe krijojnë një ekip ndërvendor për të ndjekur hapat e zbatimit të projektit. Ekipi i Projektit është përgjegjës për aspektet e ndryshme të menaxhimit të projektit përfshirë rishikimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm te planeve të punës, kordinimin e proceseve vendim-marrëse brenda strukturave drejtuese të Njësive Vendore pjesëmarrëse në projekt, marrjen e vendimeve operacionale, ndarjen e detyrave dhe mjeteve dhe realizimin e aktiviteteve kryesore si tenderimin e punëve dhe/ose shërbimeve, ndjekjen e realizimit të punës, raportimin sistematik mbi progresin e punës dhe përgatitjen e raportit perfundimtar mbi zbatimin e projektit.

Monitorimi

Monitorimi shoqëron në mënyrë të vazhdueshme planifikimin dhe zbatimin e projektit. Ai vepron si mekanizëm "vetë-kontrolli" që hedh dritë mbi progresin e projektit dhe kryhet nga personat përgjegjës për realizimin e aktiviteteve (kryesisht stafi i projektit dhe partnerët e tjerë zbatues) me synim ndryshimin dhe adaptimin e funksionimit të projektit në çdo kohë që shihet e nevojshme. Elementet monitorues janë pjesë e informacionit të projektit.

Detyrat kryesore të monitorimit janë :

- Ndjekja sistematike e të gjithë elementeve operacionale dhe administrativë, si dhe e rezultateve të aktiviteteve të projektit nga njësia e menaxhimit të projektit dhe partnerët operacionalë. "Sistematike" do të thotë e bazuar në tregues dhe mjete kontrolluese që lidhen me elementë planifikues të përcaktuar.
- Realizimi i "vetë-vlerësimit sistematik" (nëpërmjet seminareve periodike të stafit të projektit ku diskutohet mbi progresin e projektit, takimeve vlerësuese dhe informuese me partnerët e rëndësishëm dhe grupet përfituese, etj.).

Realizimi i hapave formale për drejtimin e projektit të koordinuar ndërmjet menaxhimit të projektit dhe instancave vendimarrëse (si p.sh. takimet e ekipit të drejtimit, vizitat monitoruese nga personat përgjegjës të projektit ose institucionet e tjera të interesuara, etj.).

Rezultatet kryesore të monitorimit janë:

- Raportet e progresit që përgatiten sipas një plani të përcaktuar raportimi.
- Raportet specifike mbi menaxhimin e projektit që kanë lidhje me çështjet operacionale dhe administrative (duke përfshirë raportet financiare dhe të auditimit).
- Proces-verbalet e mbledhjeve të ekipit të drejtimit që përmbledhin të gjitha vendimet mbi ndryshimet strategjike dhe konceptimin e projektit.

Monitorimi shërben gjithashtu si një kuadër referues për vlerësimin, i cili përdor shpesh të njëjtat elemente për "matjen e progresit" .

Vlerësimi

Elementet e vlerësimit (ose "elementët matës" të progresit) duhen përcaktuar që në momentin e planifikimit të indikatorëve. Rezultatet e pritshme të vlerësimit përfaqësojnë rekomandime për procesin e vendim-marrjes për orientimin e projektit në të ardhmen si dhe propozimeve konkrete për ri-përcaktimin dhe/ose ri-adaptimin e elementeve planifikues (objektivave, linjave të aktiviteteve , etj.).

Detyra të rëndësishme të vlerësimit janë:

- Zhvillimi i një koncepti të qartë mbi vlerësimin (Termat e Referencës) që përcaktojnë llojin e vlerësimit (p.sh.

paraprak, afat-mesëm ose përfundimtar), rezultatet e pritshme dhe produktet e vlerësimit (d.m.th. elementet vendim-marrës mbi të ardhmen e projektit), procedurat dhe metodat, si dhe kërkesat mbi raportimin.

- Ndërmarrja e hapave sistematikë të vlerësimit (sipas programit të aprovuar) me pjesëmarrjen e aktorëve të interesuar dhe ekspertëve të mandatuar.
- Shqyrtimi i gjetjeve për të propozuar marrjen e vendimeve të drejta mbi orientimin e projektit në të ardhmen (ndryshimet dhe adaptimet e nevojshme).
- Raportimi i gjetjeve, konkluzioneve rreth progresit të raportitit, ndikimit të tij, si dhe rekomandimet rreth orientimit të projektit në të ardhmen.

Produktet e vlerësimit të projektit janë:

- Raporti i vlerësimit mbi gjetjet dhe rekomandimet.
- Koncepti mbi planifikimin për të ardhmen ose për realizimin sistematik të projektit.

Mbyllja/Përfundimi

Sipas planifikimit, çdo projekt është i kompletuar me nje axhendë kohore të paracaktuar. Eshtë e kështillueshme që konceptimi i projektit të jetë i planifikuar mirë duke treguar situatën që nga fillimi i projektit dhe mënyrën se si pritet të ndryshojë ajo pas kryerjes së aktiviteteve.

Rezultat i rëndësishëm i mbylljes të projektit është demonstrimi dhe regjistrimi i ndikimit si dhe i mundësive mbi qëndrueshmërinë e projektit. Në disa raste përfundimi i projektit shënon fillimin e një projekti të ri, zakonisht me një tematikë të re, por bazuar në të njëjtat përvoja dhe rezultate të aktiviteteve të realizuara.

Detyrat tipike të fazës së mbylljes janë:

- Përpunimi sistematik i të gjitha eksperiencave që mund të aplikohen në projekte të ngjashme ose për aktorë të tjerë që mund të gjenden në situata të ngjashme pune.
- Përgatitja e transferimit të përgjegjësive të projektit ose linjave të aktiviteteve tek partnerët e përzgjedhur. Ky skenar planifikohet shpesh ne fazën fillestare të projekteve afat-mesme dhe afat-gjata. Kjo do të thotë që partnerët përgjegjës duhet të ndërgjegjësohen dhe të përgatiten për detyrat dhe përgjegjësitë që kanë lidhje me aktivitetet e ndjekjes së problemeve.
- Përgatitja e vlerësimit final (vlerësimi përfundimtar ose studimi i ndikimit të projektit).

Produktet e përfundimit të projektit janë :

- Raportet finale (duke përfshirë raportet e vlerësimit).
- Dokumentet e marrëveshjeve.

Përgjatë gjithë fazave të MCP, që nga planifikimi deri tek raportimi përfundimtar, ekipi i punës përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e projektit i kushton një vëmendje të veçantë qëndrueshmërisë së rezultateve të projektit pas përfundimit të tij duke parashikuar veprime konkrete individuale dhe të përbashkëta në vazhdimësi.

PLANIFIKIMI

Planifikimi nënkupton një kuptim të përbashkët midis aktorëve të një projekti ndërvendor (përfituesve, NJQV-ve zbatuese dhe donatorit) të elementëve kryesorë të ndërhyrjes së ardhshme si:

- Gjendja në fillim (Ku jemi tani?)
- Objektivat (Çfarë duam?)

- Strategjia (Cila është strategjia? Si mund t'i arrijmë objektivat?)
- Organizimi (Cili është përgjegjës për çfarë dhe kur?) dhe
- Burimet (Cilat janë burimet që kemi?)

Hapat kryesorë në planifikim janë paraqitur ne Tabelën 1.

Tabela 1: Hapat e planifikimit dhe metoda e kuadrit logjik

Hapat në planifikimin e projektit	Hapat në planifikimin e projektit	Metodat/Dokumentet
Hapi 1: Analiza e situatës	Analiza e palëve të interesuara; Analiza e problemveve; Potencialet	Matrica e interesave të palëve; Pema e problemeve; Analiza e sistemit; Marreveshjet paraprake (p.sh., Marrveshja paraprake e bashkepunimit ndervendor)
Hapi 2: Qëllimi i përgjithshëm	Analiza e objektivave	Pema e objektivave
Hapi 3: Alternativat (përfshirë vendimin)	Analiza e alternativave	Avantazhet dhe disavantazhet
Hapi 4: Strategjia e projektit	Kuadri logjik: Hierarkia e objektivave; Supozimet; Indikatorët dhe burimet e verifikimit; Burimet	Kuadri logjik/matrica e projektit
Hapi 5: Dokumenti i planifikimit	Përshkrimi i qëllimit, objektivave, produkteve dhe aktiviteteve të projektit; Organizimi (rolet dhe përgjegjësitë); Buxheti; Monitorimi dhe vlerësimi	Propozimi i Projektit (ose Dokumenti i Projektit); Marreveshjat perkatese (p.sh., marrveshja e bashkepunimit ndervendor).

Planifikimi me metodën e kuadrit logjik është një nga më të përdorurat kohët e fundit. Figura 2 paraqet hapat e planifikimit me metodën e kuadrit logjik.

Figura 2: Hapat e planifikimit me metodën e kuadrit logjik

Palët e interesuara



Pema e problemeve



Pema e objektivave



Matrica e projektit

Objektivat	Treguesit	Burimet	Supozimet
Qëll. i përgj.			
Objektiva/t			
Produktet/ Rezultatet 1) 2) 3) n)			
Aktivitetet 1.1. 1.2. 1.n. 2.1. 2.2. 2.n. 3.1. 3.2. 3.n.	Kostot		

Lidhja e efekteve me shkaqet

Lidhja e mjeteve me qëllimet

1. Analiza e situatës

Analiza e palëve të interesuara

Analiza e problemeve

2. Analiza e objektivave

3. Analiza e alternativave/vendimi

4. Matrica e projektit

5. Dokumenti i planifikimit

HAPI 1: ANALIZA E SITUATËS

Analiza e situates përfshin analizën e palëve të interesuara dhe të problemeve në kontekstin e mjedisit aktual.

Analiza e palëve të interesuara/ pjesëmarrjes është një paraqitje e përgjithshme e:

- Aktorëve (organizatave, grupeve, apo personave) të prekur direkt apo indirekt nga projekti;
- Interesave të tyre, pritshmërive dhe kundërshtimeve.

Hapat kryesore përfshijnë:

1. Listimi i të gjithë aktorëve potencial;
2. Kategorizimi përfshirë përfituesit, pjesëmarrësit aktivë, grupet e synuara, grupet e prekura negativisht, kundërshtarët, etj.
3. Analiza e aktorëve.

Çfarë duhet patur parasysh gjatë analizës së palëve të interesuara?

- Marrja në konsideratë e perspektivave të ndryshme.
- Organizimi i pjesëmarrjes së të gjithë grupeve të prekura (sidomos grupeve të pa-privilegjuara si gratë, etj.).
- Marrja parasysh e karakteristikave kulturore dhe realiteteve shoqërore.

Nje instrument për analizën e palëve të interesuara është matrica në Tabelën 2.

Tabela 2: Analiza e palëve të interesuara

	Kriteret		
Palët e interesuara	1	2	n
Rëndësia e aktorëve për problemin ose projektin			
Potencialet e aktorëve për të kontribuar në zgjidhjen e problemit			
Rezistenca e pritshme nga aktorët			
Strategjitë për të siguruar angazhimin			

Në Tabelën 3 është paraqitur një shembull ilustrues nga një projekt konkret.

Objektivat e analizës së problemit janë:

- Paraqitja e përgjithshme e problemeve më të rëndësishme që projekti supozohet të zgjidhë (tërësisht ose pjesërisht).
- Analiza e lidhjeve mes problemeve (analiza shkak-pasojë).

Hapat gjatë analizës së problemit:

1. Listimi i problemeve.
2. Identifikimi i problemit qëndror si pikënisje.
3. Identifikimi i shkaqeve të problemit qëndror (rrënjët).
4. Identifikimi i pasojave të problemit qëndror (degët).
5. Ndërtimi i pemës së problemeve.
6. Rishikimi i pemës së problemeve për vlefshmërinë dhe plotësinë e saj.

Gjate analizës së problemit duhet të kemi parasysh se:

- Problemi nuk është mungesë zgjidhje, por ekzistencë e një gjendje negative.
- Problemet janë të lidhura me njerëzit.
- Eliminimi i problemeve aktuale duhet të lidhet ngushtë me potencialet.

Nje instrument për analizën e problemit është pema e problemeve (Figura 3).

Figura 3: Pema e problemeve



Figura 4 është ilustrimi i analizës së problemit në një projekt konkret.

Tabela 3: Analiza e palëve të interesuara për projektin
"Organizimi i përbashkët ndërvendor i shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Pukë, Komunat Qerret dhe Rrape"

Palët e interesuara	Rëndësia e aktorëve për problemin ose projektin	Potencialet e aktorëve për të kontribuar në zgjidhjen e problemit	Rezistenca e pritshme nga aktorët	Strategjitë për të siguruar angazhimin
Bashkia Pukë	Ofruesi kryesor i shërbimit të pastrimit për qytetin e Pukës. Kërkon: Rishikim të planit të menaxhimin e mbetjeve; Rehabilitim të infrastrukturës për grumbullimin e mbetjeve; Kosto më të ulët; Staf të trajnuar.	Ka staf me experience në zbatimin e projekteve; Siguron bashkë-financimin e projektit.	Buxhet i pamjaftueshëm vendor për të kryer investime kapitale.	Kontribut në masën 20% të vlerës së investimit; Drejtimi i projektit; Hartimi i një marrëveshje per bashkepunimin ndervendor; Trajnimi i stafit për menaxhimin e mbetjeve; Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese.
Komuna Qerret	Përgjëgjese për ofrimin e shërbimit të pastrimit në territorin e komunës. Aktualisht nuk e plotëson këtë shërbim. Kërkon: Shërbimin e pastrimit; Staf të trajnuar; Kosto efektive të shërbimit.	Angazhohet në sensibilizimin e komunitetit për mbledhjen e mbeturinave në pikat e caktuara.	Buxhet i pamjaftueshëm vendor për të kryer investime kapitale.	Marreveshje per bashkepunim ndervendor; Leje për vend-depozitimit pranë komunës; Ngritja e infrastrukturës për grumbullimin e mbetjeve; Trajnimi i stafit për menaxhimin e mbetjeve.
Komuna Rrape	Përgjegjëse për ofrimin e shërbimit të pastrimit në territorin e komunës. Aktualisht nuk e plotëson këtë shërbim. Kërkon: Shërbimin e pastrimit; Staf të trajnuar; Kosto efektive të shërbimit.	Angazhohet në sensibilizimin e komunitetit për mbledhjen e mbeturinave në pikat e caktuara.	Buxhet i pamjaftueshëm vendor për të kryer investime kapitale.	Marrëveshje per bashkëpunim ndërvendor; Ngritja e infrastrukturës për grumbullimin e mbetjeve; Trajnimi i stafit për menaxhimin e mbetjeve.
Komunitetet e tre NJQV-ve	Janë përfituesit e shërbimit të pastrimit. Ata duan: Mjedis të pastër; Tarifa të ulta të shrëbimit	Kanë dëshirën për të kontribuar në mbarëvajtjen e projektit dhe në mirëmbajtjen e investimit.	Anëtarë të komunitetit të komunës Qerret kanë ankesa lidhur me ndërtimin e vend depozitimit të mbeturinave pranë kësaj komunë.	Sensibilizim i komunitetit për përfitimet nga investimi dhe pagesën e tarifave të shërbimit.
dldp	Objektivat e dldp përputhen me objektivat e projektit ndërvendor (më konkretisht me objektivën qe synon përmirësimin e shërbimeve të NJQV-ve).	Bashkëfinancim të projektit; Ekspertizë të stafit për menaxhimin e projektit.	Përmbushja e kritereve të përcaktuara paraprakisht, kryesisht bashkëfinancimi me 20% i vlerës së buxhetit, kushtëzojnë financimin.	Hartimi i kritereve për bashkë-financimin e projektit; Organizimi i procesit të konkurimit për projektet e paraqitura; Bashkë-finnacimi i projektit në masën 80% të vlerës së projektit të përbashkët.
Te tjerë	….	…	…	…

Figura 4: Pema e Problemeve

Projekti "Organizimi i paërbashkët ndërvendor i shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Pukë, komunat Qerret dhe Rrape": Pema e problemeve



HAPI 2: OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

Ka disa metoda për zhvillimin e qëllimit të përgjithshëm të projektit dhe përcaktimin e objektivave, njera prej të cilave është pema e objektivave.

Objektivat e këtij hapi janë:

- Paraqitja e situatës që do të arrihet me zgjidhjen e problemeve;
- Qartësimi i lidhjes midis objektivave (mjetet dhe qëllimi);
- Qartësimi i alternativave të mundshme.

Hapat kryesorë në analizën e objektivave:

1. Riformulimi i situatave negative (problemet) në situata pozitive (objektivat) të dëshirueshme dhe të arritshme;
2. Verifikimi i lidhjes midis mjeteve dhe qëllimit për vlefshmërinë dhe plotësinë (nëse është e nevojshme, rishikimi i formulimit të objektivave dhe formulimi i objektivave të tjera të nevojshme);
3. Ndërtimi i pemës së objektivave.

Për tu patur parasysh gjatë analizës:

- Mospërfshirja e objektivave të padëshirueshme ose të panevojshme.
- Formulimi i objektivave si situata pozitive ose kushte për t'u arritur në të ardhmen.

Nje instrument për analizën është pema e objektivave (Figura 5).

Figura 5: Pema e Objektivave



Figura 6 paraqet pemën e objektivave të një projekti konkret.

HAPI 3: ALTERNATIVAT

Objektivat e këtij hapi janë:

- Identifikimi i zgjidhjeve që mund të zhvillohen si strategji të projektit;
- Vlerësimi i fizibilitetit të alternativave të ndryshme;
- Zgjedhja e një ose disa strategjive për projektin.

Hapat në analizën e alternativave janë:

1. Eliminimi i objektivave që nuk janë të dëshirueshme ose të arritshme;
2. Identifikimi i zinxhirit mjete-qëllime që përfaqësojnë strategji të projektit;
3. Identifikimi i strategjive më të mira në rrethanat e dhëna dhe në lidhje me interesat e grupit të synuar ose të përfituesit. Kriteret e mundshme për përzgjedhjen e alternativës më të mirë përfshijnë:
    - Probabiliteti i arritjes së objectives;
    - Qëndrueshmëria;
    - Pranimi shoqëror;
    - Pranimi politik;
    - Burimet në dispozicion dhe eficenca;
    - Teknologjia;
    - Kapaciteti institucional.

Për tu patur parasysh gjatë analizës:

- Dakortësimi për një strategji të projektit dhe përzgjedhja e objektivës (objektivave) të projektit.
- Në se duhet të arrihen disa objektiva, projekti mund të ndahet në disa nën-projekte.

Në një projekt, strategjitë mund të përzgjidhen në vartësi të financimit. Psh në rastin e bashkëpunimit ndërvendor midis Pukës, Qerretit dhe Rrapes, partnerët kanë zgjedhur strategjinë 1, 2, 3 dhe 6 (shih figurën në faqen tjetër). Në një rast tjetër mund të zgjidheshin strategjitë 1 dhe 4 ose 1, 2 dhe 3, në vartësi të situatës.

Figura 6: Pema e objektivave

Projekti "Organizimi i paërbashkët ndërvendor i shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Pukë, komunat Qerret dhe Rrape": Pema e objektivave



Figura 7: Analiza e alternativave

Projekti "Organizimi i paërbashkët ndërvendor i shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Pukë, komunat Qerret dhe Rrape": Alternativat



HAPI 4: STRATEGJIA/ NDËRHYRJA E PROJEKTIT

Matrica e projektit

Thelbi i metodës së kuadrit logjik është matrica e projektit që përmbledh elementët kryesorë të projektit. Kuadri logjik jep përgjigje për:

Pse bëhet projekti?	▶	**logjika e ndërhyrjes.**
Çfarë pritet të arrijë projekti?	▶	**qëllimi dhe objektivat e përgjithshme.**
Si do ta arrijë projekti atë?	▶	**rezultatet e prishme dhe aktivitetet.**
Sa do të kushtojë projekti?	▶	**mjetet dhe kostot.**
Si do të matet arritja e objektivave?	▶	**indikatorët.**
Ku gjendet informacioni për matjen e arritjes së objektivave?	▶	**burimet e verifikimit.**
Cilët faktorë të jashtëm janë të rëndësishëm për suksesin?	▶	**supozimet.**
Cilat parakushte duhet të përmbushen përpara fillimit të projektit?	▶	**parakushtet.**

Tabela 4 tregon matricën bazë të kuadrit logjik.

		Hierarkia e objektivave Përmledhje e strategjisë së projektit	Indikatorët	Burimet e verifikimit	Supozimet
Efektet e projektit	**Vizioni afat-jatë**	**Qëllimi i përgjithshëm** Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe përdorimit të burimeve natyrore *(Përfitimet rrjedhin nga përdorimi i produkteve të projektit, adoptimi i praktikave të përmirësuara dhe ndryshimi në sjelljen)*	Tregoni në se janë arritur përmirësimet e synuara		
	Efektet direkte	**Objektivat e projektit** Ndryshimet në sjellje dhe kapacitete tek personat dhe institucionet e synuara *(Përdorimi i produkteve të projektit, adoptimi i praktikave të përmirësuara dhe ndryshimi i sjelljes)*	Tregoni në se është arritur ndryshimi i synuar		Kushtet kuadër për të arritur qëllimin e përgjithshëm
Fusha operacionale *(Përgjegjësi e agj. zbatuese)*		**Rezultatet** Produktet dhe shërbimet e ofruara nga projekti *(Trajnim, dije, aftësi, sjellje, teknologji, instrumente, metoda, burime)*	Tregoni në se janë shprehur rezultatet e projektit në sasi dhe cilësi		Kushtet kuadër për të arritur objektivat e projektit
		Aktivitetet Aktivietet e projektit për të arritur produktet	*Mjetet, kostot, burimet financiare, materiale dhe njerëzore*		Kushtet kuadër për të dhënë rezultatet
					Parakushtet për të filluar projektin

Diagrama në Figurën 8 tregon përgjegjësitë e ndryshme të donatorit dhe agjencia zbatuese.

Figura 8: Kuadri logjik dhe ndarja e përgjegjësive midis donatorit dhe agjensisë zbatuese



Dizenjimi i projektit bazuar në kuadrin logjik

Kuadri logjik është ndër formatet më të përdorur për përshkrimin dhe paraqitjen e projekteve. Ai është i detyrueshëm si një pjesë integrale e dokumenteve të projektit për shumicën e donatorëve.

Kolona e parë:
Hierarkia e objektivave dhe strategjia e projektit

Logjika bazë e kolonës së parë të kuadrit logjik përkon me logjikën e përdorur në analizën e problemeve dhe objektivave nëpërmjet pemës së problemeve dhe objektivave: secili nivel lidhet me nivelin tjetër më të lartë nëpërmjet një marrëdhënje shkak-pasojë ose mjet-qëllim. Duke ekzekutuar aktivitetet e planifikuara, projekti do të japë produktet/rezultatet e planifikuara. Kur janë arritur produktet e planifikuara, projekti duhet gjithashtu të jetë në gjendje të arrijë objektivat e tij. Në se janë arritur objektivat, atëherë projekti duhet të jetë në gjendje të kontribuojë për arritjen e qëllimit të përgjithshëm.

Hierarkia e objektivave është paraqitur me poshtë:



Kolona e parë e kuadrit logjik përshkruan elementet kryesore që

përcaktojnë strategjinë bazë të projektit ose logjikën e ndërhyrjes në zinxhirin shkak-pasojë. Ajo përshkruan çfarë do të bëjë projekti përsa i përket ekzekutimit të aktiviteteve dhe dhënies së produkteve më qëllim që të arrihen efektet e dëshiruara, të cilat janë përcaktuar si objektiva dhe qëllim i përgjithshëm i projektit. Hapat për të zhvilluar kolonën e parë përfshijnë:

Identifikimi i objektivave të projektit. Bazuar në strategjinë e projektit, sikurse është përcaktuar me ndihmën e pemës së objektivave, identifikojmë objektivat e projektit në termat e përmirësimit në situatën ose ndryshimit në sjelljen dhe kapaciteteve e grupit të synuar.

Identifikimi i qëllimit të përgjithshëm. Nga niveli më i lartë i pemës së objektivave, zgjedhim qëllimin e përgjithshëm për të cilin projekti do të kontribuojë duke arritur objektivat e tij. Qëllimi është formuluar në termat e përmirësimit të kushteve të jetesës së përfituesve direktë dhe indirektë dhe në termat e stabilizimit ose përmirësimit të situatës të burimeve të tyre natyrore.

Identifikimi i produkteve/rezultateve të pritshme të projektit. Duke analizuar elementet e pemës së objektivave poshtë nivelit ku ne kemi përzgjedhur objektivat e projektit, mund të identifikojmë rezultatet e pritshme/produktet e nevojshme për arritjen e objektivave. Nëse janë të nevojshme produkte të tjera, ato duhet të identifikohen nëpërmjet një analizë shtesë. Në shumë raste, strategjitë e projektit mund të grupohen në një numër komponentësh bazë të projektit duke përcaktuar një produkt për secilin komponent si më poshtë:

- Zhvillimi i kapacitetit institucional dhe burimeve njerëzore;
- Prodhimi, përpunimi ose ndërtimi (në rastet e projekteve të infrastrukturës);
- Marketimi; etj.

Identifikimi i aktiviteteve të projektit. Për secilin produkt duhet të planifikohen aktivitetet përkatëse. Në këtë stad të planifikimit, është e mjaftueshme të përshkruhen vetëm aktivitetet e përgjithshme ose linjat e veprimit. Kalendari i detajuar i aktiviteteve bëhet në planifikimin operacional.

Kolona e katërt:
Faktorët e jashtëm, supozimet

Pas përzgjedhjes së strategjisë, mbeten objektivat e papërfshira në logjikën e ndërhyrjes dhe faktorë të tjerë të jashtëm. Këto mund të jenë themelore për arritjen e produkteve/rezultateve të pritshme, objektivave dhe qëllimit të projektit, por janë jashtë kontrollit direkt të projektit. Këto elemente bëhen kushte në mënyrë që strategjia e projektit të jetë e suksesshme. Në planifikim, këto kushte janë përshirë si supozime në kolonën e katërt të matricës së projektit.

Për të vlerësuar shkallën e rrezikut që këto kushte përbëjnë për projektin, duhet të vlerësohet probabiliteti dhe rëndësia e tyre. Disa nga ato mund të jenë kritike për suksesin e projektit, të tjerat mund të injorohen. Faktorët e rrezikut formulohen si situata pozitive (supozime).

Supozimet nuk formulohen në nivel të qëllimit të përgjithshëm. Sidoqoftë, ka kushte të tjera që duhet të plotësohen përpara se të fillojë projekti. Këto parakushte (p.sh. vendimi pozitiv i agjencisë donatore për financimin e propozimit) vendosen në kuadratin më të ulët të kolonës së katërt të matricës së projektit, një nivel nën aktivitetet. Skema e paraqitur në Figurën 9 përdoret për të verifikuar qartësinë e elementëve konceptuale të matricës së projektit.

Figura 9: Kuptimi i elementëve konceptuale të matricës së projektit



Në figurën 10 është paraqitur matrica e kuadrit logjik për një projekt konkret me kolonën e parë dhe të katërt të plotësuar.

Figura 10: Matrica e kuadrit logjik--kolona e parë dhe katërt për projektin

"Organizimi i përbashkët ndërvendor i shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Pukë, Komunat Qerret dhe Rrape"

Hierarkia e objektivave **Përmledhje e strategjisë së projektit**	**Indika-torët**	**Burimet e verifikimit**	**Supozimet**
Qëllimi i përgjithshëm Përmirësimi i shërbimeve të pastrimit në tre NJQV-të			
Objektivat e projektit 1. Hartimi i planit të MB 2. Ndërtimi i infarstrukturës së pastrimit 3. Ndërgjegjësimi i komunitetit 4. Rritja e kapaciteteve të stafit te NJQV per MB&MCP			Respektimi i marrëveshjes së hartuar nga të tre NJQV-të
Rezultatet 1.1 Krijimi dhe përdorimi i një skeme efektive dhe efiçente ndërvendore për menaxhimin e mbetjeve. 1.2 Monitorimi i zbatimit të skemës së grumbullimit të mbetjeve ndërvendore për menaxhimin e mbetjeve. 2.1 Infrastrukturë e përmirësuar e grumbullimit të mbetjeve urbane. 2.2 Vend-depozitimi i mbetjeve në Fushë-Qarri sipas kërkesave të lejes mjedisore. 3 Komunitet i ndërgjegjësuar dhe i përfshirë në aktivitete e nisma lokale për menaxhimin e mbetjeve urbane. 4 Staf i trajnuar për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane.			Marrëveshje për ofrimin e vazhdueshëm të shërbimit të pastrimit
Aktivitetet • Hartimi i marrëveshjes së bashkëpunimit midis tre NJQV-ve. • Hartimi i skemës ndërvendore për organizimin e përbashkët të grumbullimit të mbetjeve. • Prokurimi i pajisjeve dhe punimeve. • Rehabilitimi i infrastrukturës së mbetjeve. • Monitorimi i skemës, kostove dhe matja e kënaqësisë së publikut. • Trajnimi i stafit teknik dhe kordinatorëve të tre njësive vendore menaxhimin dhe grumbullimin e mbetjeve. • Kryerja e fushatave të sensibilizimit dhe edukimit me komunitetin e njësive vendore.			Vend depozitimi i mbetjeve urbane të bashkisë Pukë në Fush Qarre nuk ka probleme pronësie; Stafi i bashkisë i gatshëm të marrë pjesë në trajnime; Komuniteti i hapur ndaj informimit për projektin dhe pagesën e shërbimit.
			Përputhje me strategjinë e dldp

Kolona e dytë: indikatorët

Në shumicën e rasteve, arritja e qëllimeve, objektivave dhe produkteve nuk mund të verifikohet nga vëzhgimi direkt. Qëllimi i indikatorëve është t'i bëjë qëllimet, objektivat dhe produktet cilësore, të matshme dhe të vëzhgueshme. Indikatorët shpesh përmbajnë vlera për një afat kohor të caktuar.

Indikatorët duhet të jenë të verifikueshëm objektivisht. Me fjalë të tjera nuk duhet të varen në mendimin/gjykimin subjektiv. Ato janë baza më e rëndësishme për monitorimin gjatë zbatimit të projektit.

Duke vëzhguar rregullisht treguesit që tregojnë në se një qëllim, objektivë, apo produkt është arritur sikurse është planifikuar, përgjegjësit për projektin mund të sigurohen se zbatimi i projektit po bëhet siç duhet. Indikatorët iu referohen karakteristikave të rëndësishme të qëllimit, objektivave dhe produktit përkatës. Prandaj, përcaktimi i indikatorëve ndihmon verifikimin në se qëllimi, objektivat dhe produktet janë formuluar në mënyrë realiste dhe të saktë.

Përdorimi i indikatorëve shpesh kërkon informacion që grupi i menaxhimit të projektit duhet ta përfitojë nga burime të caktuara. Këto burime informacioni përshkruhen për secilin indikator në kolonën e tretë të matricës së projektit, nën titullin "Burimet e verifikimit".

Në Metodën e Kuadrit Logjik, indikatorët identifikohen gjatë planifikimit të projektit. Në kolonën e dytë të matricës së projektit, indicatorët identifikohen për tre nivelet e larta të hierarkisë së objektivave: produktet, objektivat dhe qëllimi.

Përderisa ekzekutimi i aktiviteteve është direkt i vëzhgueshëm (aktiviteti është ekzekutuar: po ose jo) asnjë indikator nuk përcaktohet në nivel të aktiviteteve. Kuadratet përkatës të matricës së projektit përdoren për të përmbledhur mjetet dhe kostot e projektit.

Kolona e tretë: Burimet e verifikimit

Në këtë kolonë vendosen burimet se ku do të verifikohet realizimi i objektivave (kolona e parë).

Këto burime mund të jenë, raporte, informacione, vëzhgime në terren, etj.

Ne figurën 11 është paraqitur matrica e kuadrit logjik për një projekt konkret me kolonën e dytë dhe të tretë të plotësuar.

Mjetet dhe kostot

Sikurse është përmendur me lart, dy kuadratet e mesëm në nivel të aktiviteteve mund të përdoren për të identifikuar mjetet dhe kostot e projektit. Mjetet janë burimet fizike dhe jo-fizike të nevojshme për ekzekutimin e aktiviteteve të planifikuara (burimet). Ne mund të dallojmë burimet materiale nga ato njerëzore.

Kostot janë burimet financiare të nevojshme për të siguruar burimet materiale dhe njerëzore të projektit. Kostot detajohen në buxhet/preventiv dhe paraqiten në një format të standartizuar.

Këto dy kuadrate të matricës përmbajnë vetëm një përmbledhje të mjeteve dhe kostove të projektit. Detajet jepen në dokumentin e projektit.

Figura 11: Matrica e kuadrit logjik--kolona e dytë dhe e tretë për projektin

"Organizimi i përbashkët ndërvendor i shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Pukë, Komunat Qerret dhe Rrape"

Hierarkia e objektivave **Përmledhje e strategjisë së projektit**	**Indika-torët**	**Burimet e verifikimit**	**Supozimet**
Qëllimi i përgjithshëm Përmirësimi i shërbimeve të pastrimit në tre NJQV-të	Nuk ka mbetje jashtë kontenierëve; Shërbimi i pastrimit kryhet ne te 3 NJQV.	Vizita në vend; Raportet e performances së shërbimit nga NJQV-të.	
Objektivat e projektit 1. Hartimi i planit të MB 2. Ndërtimi i infarstrukturës së pastrimit 3. Ndërgjegjësimi i komunitetit 4. Rritja e kapaciteteve të stafit te NJQV per MB&MCP	Skema përbashkët e grumbullimit të mbetjeve e hartuar; Infrastruktura e ngritur (1 makinë teknologjike, 62 kontenierë, 30 pika grumbullimi, 30 bazamente betoni); # takimeve me grupet e interesit; Stafi i NJQV i aftë për ofrimin dhe monitorimin e shërbimit të mbetjeve.	Skema ndërvendore, kostot, rekomandimet për tarifat e pastrimit; Grafiku i integruar i shërbimit; Dokumenti i rregullores.	Respektimi i marrëveshjes së hartuar nga të tre NJQV-të

Rezultatet 1.1 Krijimi dhe përdorimi i një skeme efektive dhe efiçente ndërvendore për menaxhimin e mbetjeve. 1.2 Monitorimi i zbatimit të skemës së grumbullimit të mbetjeve ndërvendore për menaxhimin e mbetjeve. 2.1 Infrastrukturë e përmirësuar e grumbullimit të mbetjeve urbane. 2.2 Vend-depozitimi i mbetjeve në Fushë-Qarri sipas kërkesave të lejes mjedisore. 3 Komunitet i ndërgjegjësuar dhe i përfshirë në aktivitete e nisma lokale për menaxhimin e mbetjeve urbane. 4 Staf i trajnuar për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane.	Rregullorja e mbetjeve përdoret nga NJQV-të; Performanca e shërbimit të grumbullimit të mbetjeve e vlerësuar në mënyrë periodike; Mbetjet shkarkohen në vend depozitimin e Fushë Qarrit- Performancë e rritur e stafit të shërbimit; % e banorëve shprehen të kënaqur me shërbimin.	Lista e indikatorëve të monitorimit të skemës; Formularët e plotësuar të matjes së perfomances dhe raporti i vlerësimit; Lejet mjedisore për vend-depozitimin; Raportet e ofruesit të trajnimeve; Dosje teknike, akt kolaudimi i punimeve, situacionet, urdhër pagesat.	Marrëveshje për ofrimin e vazhdueshëm të shërbimit të pastrimit
Aktivitetet • Hartimi i marrëveshjes së bashkëpunimit midis tre NJQV-ve. • Hartimi i skemës ndërvendore për organizimin e përbashkët të grumbullimit të mbetjeve. • Prokurimi i pajisjeve dhe punimeve. • Rehabilitimi i infrastrukturës së mbetjeve. • Monitorimi i skemës, kostove dhe matja e kënaqësisë së publikut. • Trajnimi i stafit teknik dhe kordinatorëve të tre njësive vendore menaxhimin dhe grumbullimin e mbetjeve. • Kryerja e fushatave të sensibilizimit dhe edukimit me komunitetin e njësive vendore.	70,000 Euro-Vlera e projektit 56,000 Euro-Buxheti i kërkuar nga dldp 14,000 Euro-Buxheti i kontribuar nga NJQV Pukë		Vend depozitimi i mbetjeve urbane të bashkisë Pukë në Fush Qarre nuk ka probleme pronësie; Stafi i bashkisë i gatshëm të marrë pjesë në trajnime; Komuniteti i hapur ndaj informimit për projektin dhe pagesën e shërbimit.
			Përputhje me strategjinë e dldp

HAPI 5: DOKUMENTI I PROJEKTIT

Dokumenti i projektit përmban një përshkrim të detajuar të projektit. Ai përmban informacion rreth qëllimit, objektivave, produktet dhe aktiviteteve të projektit, organizimit dhe drejtimit të projektit, partnereve, buxhetit dhe kohëzgjatjen. Dokumenti i projektit duhet të jetë konciz, informues dhe i qartë dhe është baza për:

- Vendimin për financim nga donatori/financuesi;
- Planifikimin operacional;
- Marrëveshjet e zbatimit midis partnerëve (donatorë, agjenci zbatuese dhe partnere të tjerë).

Nuk ka një format të pranuar nga të gjithë. Disa donatorë kërkojnë përdorimin e formatit të tyre. Në Tabelën 5 janë paraqitur elementët kryesorë përbërës të dokumentit të projektit. Për të pasur një dokument projekti konciz këshillohet që informacioni shtesë ose i detajuar të vendoset në anekset. Lista e anekseve mund të përmbajë:

- Matricën e projektit;
- Strukturën organizative të projektit;
- Përshkrimin e strategjive të projektit;
- Termat e Referencës për stafin e projektit;
- Buxhetin e detajuar;
- Planin e aktiviteteve dhe burimeve;
- Draftin e zbatimit të marrëveshjeve midis partnerëve; dhe
- Materiale të tjera (projekte teknike, preventiva, profile, dokumente ligjore, harta, etj.).

PLANI I AKTIVITETEVE

Dokumenti i Projektit përmban një përshkrim të detajuar të projektit. Idealisht, ai përmban një kalendar të përgjithshëm të aktiviteteve dhe buxhetin që përcakton në mënyrë të përgjithshme çfarë do të ekzekutohet dhe arrihet në periudha të ndryshme gjatë jetës së projektit. Sidoqoftë, Dokumenti i Projektit nuk lejon menaxhimin operacional të projektit. Një plan më i detajuar është i nevojshëm dmth Plani i Aktiviteteve (PA).

Plani i Aktiviteteve është baza për zbatimin dhe monitorimin e projektit. Nga njera anë, ai shërben si një instrument menaxhimi për planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve të projektit. Nga ana tjetër, ai shërben si një bazë monitorimi për të parë në se aktivitetet e planifikuara janë ekzekutuar në kohë dhe me cilësinë e duhur dhe në se janë arritur rezultatet dhe produktet e ndryshme të projektit.

Katër elemente duhet të merren në konsideratë kur përgatitet Plani i Aktiviteteve:

- Zbërthimi i aktiviteteve kryesore të përfshira në Dokumentin e Projektit në nënaktivitete duke marre në konsideratë udhëzimet e mundshme nga donatori.
- Përfshirja e eksperiencave dhe mësimeve të nxjerra nga periudha e mëparshme (rezultatet e monitorimit kundrejt kuadrit logjik).
- Marrja në konsideratë e ndryshimeve të mundshme në kontekstin politik, ekonomik dhe institucional.
- Përgatitja e seksionit të burimeve (koha e aktiviteteve dhe burimet).

Figura 12 paraqet katër shtyllat kryesore për përgatijen e Planit të Aktiviteteve.

Figura 12: Shtyllat kryesore për PA

PLANI I AKTIVITETEVE (PA)			
Dokumenti i Projektit	Experiencat e mëparshme (Monitorimi)	Konteksti/ Rreziqet	Burimet

Në Figurat 13 dhe 14 janë paraqitur përkatësisht një format dhe një shembull i Planit të Aktiviteteve për projektin ndërvendor misids NJQV-ve Pukë, Qerret dhe Rrape (Qarku Shkodër).

Tabela 5: Përmbajtja e një projekti

Përmbledhja	Një paraqitje e pikave kryesore të projektit përfshirë objektivat, problemet kryesore, organizimin e projektit, partnerët, kohëzgjatjen dhe koston.
Gjendja fillestare	• Informacion i përgjithshëm për vendin/rajonin dhe zhvillimet e fundit. • Informacion më specifik për fushën e projektit. • Problemet të cilat projekti synon të influencojë direkt. • Potencialet ekzistuese që mund të përdorë projekti për të bërë këtë.
Objektivat	Ky seksion bazohet në kolonën e parë të kuadrit logjik (hierarkia e objektivave) dhe përshkruan logjikën e ndërhyrjes së projektit përfshirë: **Qëllimin e përgjithshëm (ose qëllimet).** • Sa kontribon projekti në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe gjendjes së burimeve natyrore? • Sa përfitime do të nxjerrin njerezit nga përdorimi i produkteve të projektit dhe adoptimi i praktikave të përmirësuara dhe ndryshimi i sjelljes? • Cilët janë treguesit kryesore që tregojnë arritjen e qëllimit të përgjithshëm. **Objektiva e projektit (objektivat).** • Çfarë ndryshimesh në sjellje dhe kapacitetin e personave kyç, njerëzve dhe institucioneve (grupeve të synuara) do të arrijë projekti? • Cilat janë efektet direkte dhe produktet e projektit? • Cilët janë treguesit kyç që tregojnë arritjen e objektivës së projektit. **Produktet dhe aktivitetet (e përgjithshme).** • Cilat produkte dhe shërbime do të ofrojë projekti? • Treguesit që tregojnë që produktet janë ofruar në sasi dhe cilësi të mjaftueshme. • Për secilin produkt përshkruhen aktivitetet e përgjithshme përkatëse.

Metodologjia	• Përfituesit dhe mbulimin gjeografik. • Niveli i ndëryrjes (makro/meso/mikro). • Metodat dhe instrumentet që do të përdoren nga projekti.
Organizimi i projektit	• Cili është organizimi i projektit? • Cilët janë partnerët e bashkëpunimit dhe rolet e tyre?
Buxheti dhe financimi	• Struktura e buxhetit korrespondon me produktet dhe aktivitetet. • Duhet të përshkruhen kontributet financiare të të gjithë partnerëve. • Për projektet më të gjata se një vit, buxheti ndahet në buxhete vjetore.
Kontrolli (drejtimi i projektit)	**Monitorimi dhe planifikimi operacional** • Çfarë duhet të vëzhgohet sistematikisht për të parë që projekti është në drejtimin e duhur? • Kush është përgjegjës për monitorimin? • Si do ë përdoren rezultatet e monitorimit? **Vlerësimi** • Si do të bëhet vlerësimi: Do të jetë i jashtëm apo i brendshëm? • Kur do të bëhet, cilat janë pikat kryesore dhe kush do të marrë pjesë në të? **Raportimi** • Duhet të jetë konciz dhe të reflektojë rezultatet e monitorimit. • Raportimi financiar merr parasysh strukturën e buxhetit dhe bën krahasimin midis shpenzimeve të planifikuara dhe shpenzimeve të bëra. • Intervalet e raportimit janë gjithashtu të përcaktuara.
Vlerësimi i rreziqeve	Cilat janë pengesat (rreziqet) dhe mundesitë (potencialet) në kontekstin e projektit mbi të cilat projekti ka pak ose aspak influencë direkte?

Figura 13: Një format i Planit të Akiviteteve

Nr.		Muajt												Pikat kryesore (përshkrimi & data e përfundimit)	Përgjë-gjesit	Koha (ditë pune)	Buxheti	Shënime
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12					
Produkti 1:														Treguesi(t):				
A 1.1	Aktiviteti 1.1																	
A 1.2	Aktiviteti 1.2																	
A 1.3	Aktiviteti 1.3																	
Produkti 2:														Treguesi(t):				
A 2.1	Aktiviteti 2.1																	
A 2.2	Aktiviteti 2.2																	
A 2.3	Aktiviteti 2.3																	
A 2.4	Aktiviteti 2.4																	
Produkti 3:														Treguesi(t):				
A 3.1	Aktiviteti 3.1																	
A 3.2	Aktiviteti 3.2																	
A 3.3	Aktiviteti 3.3																	

Figura 14: Plani i Aktiviteteve për projektin
"Organizimi i përbashkët ndërvendor i shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Pukë, Komunat Qerret dhe Rrape"

Nr.		Muajt						Pikat kryesore (përshkrimi dhe data e përfundimit)	Përgjegjës	Koha (ditë pune)	Buxheti	Shënime
		1	2	3	4	5	6					
Produkt 1: Krijimi dhe përdorimi i një skeme efektive dhe efiçente ndërvendore për menaxhimin e mbetjeve.								Treguesit: Skema përbashkët e grumbullimit të mbetjeve e hartuar; Marrveshja e BNV e firmosur nga palët				
A 1.1	Aktiviteti 1.1 Pune pergaditore per institucional-izimin e BNV							Deri në fund të muajit të parë do të: – ngrihet grupi i punës me 3 antare, 1 nga çdo NJQV; – grumbullohen të dhenat për shërbimin e pastrimit për të 3 NJQV-ve	Bashkia Pukë	10		
A 1.2	Aktiviteti 1.2 Hartimi i marrëve-shjes së bash-këpunimit midis tre NJQV-ve.							Deri në fund të muajit të dytë do të: – identifikohen potencialet dhe nevojat e shtrirjes së shërbimit; – shkëmbehet eksperienca për BNV me bashkitë Rubik e Rreshen; – konsultohet drafti paraprak i BNV me aktorët e projektit.	Bashkia Pukë Ekspertet e dldp per hartimin e marrveshjes se BNV	10		
A 1.3	Aktiviteti 1.3 Hartimi i skemës ndërvendore për or-ganizimin e përbashkët të grumbullimit të mbetjeve							Deri në fund të muajit të dytë do të: – llogariten kostot individuale për shër-bimin e pastrimit të NJQV; – llogaritet kostua për shërbimin e përbash-këtë të pastrimit; – llogariten tarifat e shërbimit për çdo komunë; – hartohet grafiku i transportimit të pleh-rave me makinën teknologjike.	Bashkia Pukë&Ek-spertët e dldp për menax-himin e mbet-jeve	15		

Produkti 2: Monitorimi i zbatimit të skemës së grumbullimit të mbetjeve ndërvendore për menaxhimin e mbetjeve.								Treguesi: Infrastruktura e ngritur e shërbimit të pastrimit (1 makinë teknologjike, 62 kontenierë, 30 pika grumbullimi, 30 bazamente të mbetjeve).				
A 2.1	Aktiviteti 2.1 Prokurimi i pajisjeve dhe punimeve							Deri në fund të muajit V do të shpallet firma fituese	Bashkia Pukë	30		
A 2.2	Aktiviteti 2.2 Rehabilitimi i infrastrukturës së mbetjeve.							Deri në fund të muajit VI do të: – Lidhet kontrata me firmën fituese; – Zgjerohet infrastruktura e vend depozitimit Fush Qarre & vendosen kontenirët.	Bashkia Pukë	45		
A 2.3	Aktiviteti 2.3 Monitorimi i skemës, kostove dhe matja e kënaqësisë së publikut							Dy ditë, në çdo jave të muajit, do të organizohen vizita në vend për monitorimin e skemës së pastrimit.	Bashkia Pukë; komunat Qerret&Rrape	20		

Produkti 3:…								Treguesi(t):…				
A 3.1	Aktiviteti 3.1…											
A 3.2	Aktiviteti 3.2…											
A 3.3	Aktiviteti 3.3…											

Aneksi 1: Përmbledhje e projektit "Organizimi i përbashkët ndërvendor i shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Pukë, Komunat Qerret dhe Rrape"

Përshkrimi i situatës

Bashkia e Pukë, qarku Shkodër siguron shërbimin e pastrimit për banorët e saj nëpërmjet grumbullimit, transportit dhe depozitimit të mbetjeve urbane në fushën e depozitimit. Aktualisht, ky shërbim nuk është në nivelin dhe shtrirjen e duhur dhe komuniteti është i pakënaqur për cilësinë e tij. Për rrjedhojë, ka ndotje të mjedisit dhe të ujrave sipërfaqësore, degradim të mjedisit përreth sheshit të depozitimit të mbetjeve në Fushë Qarre; jeta e qytetarëve është në rrezik të vazhdueshëm nga sëmundjet infektive dhe përhapja e tyre, etj.

Shkaqet kryesore të kësaj situate lidhen me një planifikim të pamjaftueshëm për menaxhimin e mbetjeve nga ana e bashkisë. Mbetjet urbane nuk largohen rregullisht nga pikat e grumbullimit apo nga rrugët e qytetit; mjetet dhe pajisjet e pastrimit janë të amortizuara; infarastruktura pastrimit e pamjaftueshme duke përfshirë kontenierë të dëmtuar në masën mbi 70% të tyre dhe pika grumbullimi të hapura jo të standartizuara (nga 60 pika 15 prej tyre janë të hapura) dhe pika të hapura ilegale; shtrirje e pamjaftueshme e shërbimit në zonat rurale; depozitimi dhe sistemimi i mbetjeve në sheshin e depozitimit Fushë Qarre jo i përshatashëm dhe sipas kritereve për ruajtjen e mjedisit. Shkaqe të tjera të rëndësishme përfshijnë planifikimim jo të përshtatshëm ndërvendor; hedhja pa kriter e mbetjeve në hapësira publike dhe në ujrat sipërfaqësore; promovim i pamjaftueshëm i komunitetit për ruajtjen e mjedisit; kosto të larta të shërbimit dhe buxhete të pamjaftueshme vendorë për kryerjen e investimeve kapitale; arkëtimi i ulët i tarifave të shërbimit, kapacitete njerzore të pamjaftueshme për menaxhimin e mbetjeve urbane,

Në Komunat Qerret e Rrape mungojnë shërbimet periodike të pastrimit dhe të grumbullimit të mbetjeve. Mbetjet largohen vetëm në dy-tre vende pranë zyrave vendore, mungon infrastruktura e mbetjeve (makina teknollogjike dhe kontenierë). Ato nuk kanë një shesh të miratuar për depozitimin e mbetjeve dhe për më tepër nuk kanë asnjë skemë lokale për organizimin e këtij shërbimi. Për pasojë, në pjesën më të madhe të territorit rural mbetjet nuk mblidhen. Gjithashtu, stafi i komunave është i pa kualifikuar për menaxhimin e mbetjeve dhe komuniteti i pa informuar lidhur me ruajtjen e mjedisit.

Në kuadrin e programit dldp/Intercooperation Shqipëri, Bashkia Pukë identifkoi mundësinë e një bashkëpunimi me komunat Qerret dhe Rrape, Qarku Shkodër. Projekti i propozuar synom përmirësimin e cilësisë dhe efiçencës së shërbimit të pastrimit në të tre njësitë vendore. Nëpërmjet këtij projekti bashkëpunimi ndërvendor synohet përmirësimi i cilësisë së jetesës së banorëve të bashkisë Puke dhe komunave Qerret e Rrape.

Qëllimi i projektit

Përmirësimi i shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve urbane drejt krijimit të një mjedisi të pastër dhe të qëndrueshëm në zonën e Pukës.

Objektiva specifike e projektit

- Menaxhimi efektiv dhe efikas i mbetjeve urbane nëpërmjet bashkëpunimit ndërvendorë të 3 njësive vendore.
- Ndërgjegjësimi i komunitetit të zonës për mbajtjen e një mjedisi të pastër dhe për zbatimin e skemës pilot për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve.
- Rritja e kapaciteteve të stafeve të 3 njësive vendore për menaxhimin e mbetjeve dhe zbatimin e projekteve.

Rezultatet e pritshme

- Krijimi dhe përdorimi i një skeme efektive dhe efikase ndërvendore për menaxhimin e mbetjeve.
- Monitorimi i zbatimit të skemës së grumbullimit të mbetjeve.
- Staf i trajnuar për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane.
- Infrastrukturë e përmirësuar e grumbullimit të mbetjeve urbane.
- Vend depozitimit të mbetjeve ne Fush Qarri sipas kërkesave të lejes mjedisore.
- Komunitet i ndërgjegjësuar dhe i përfshirë në aktivitete e nisma lokale për menaxhimin e mbetjeve urbane.

Aktivitetet kryesore

- Krijimi i grupit të punës me përfaqësues te 3 NJQV-ve për organizimin e përbashkët ndërvendor i shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve;
- Organizimi i një bashkëpunimi ndërvendor për hartimin e një skeme të përbashkët për grumbullimin e mbetjeve urbane, diskutimi me grupet e interesit e aprovimin në këshillat vendore;
- Trajnimet e stafit teknik dhe koordinatorëve të 3 njësive vendore për zbatimin, kontrollin, monitorimin e skemave te grumbullimit te mbetjeve;
- Prokurimi publik i blerjes së makinës teknologjike, kontenierëve si dhe punimeve për ndërtimin e xhepave (vend vendosja e kontenierëve) të vendosjes së kontenirëve dhe punimeve për përmirësimin e fushës së depozitimit të mbetjeve,

shpallja fituesit dhe lidhja e kontratave me fituesit;

- Zbatimi i kontratave për blerjet e makinës teknologjike, kontenierëve dhe të punimeve sipas projektit teknik e kushteve teknike, kolaudimi dhe marrjen në dorëzim;
- Zbatimi i skemave të përbashkëta të grumbullimin të mbetjeve dhe i punimeve për rehabilitimin e infrastrukturës së mbetjeve;
- Monitorimi i skemës, kostove dhe matja e kënaqësisë së publikut ;
- Organizimi i aktiviteteve sensibilizuese, edukuese e informuese me komunitetin për një mjedis të pastër.

Përfituesit e projektit

Përfitues direkt të projektit janë:

- Rreth 12 mijë banorë të Bashkisë Puke, Komunave Qerret dhe Rrape.
- Gratë, fëmijët e të moshuarit do kenë mjedise të pastra për çlodhje e argëtim.
- 200 biznese të vogla e të mesëm, të cilët do kenë rritje të ardhurave nga përmirësimi i mjedisit, por edhe nga rritje e numrit të vizitorëve vendas e të huaj.
- 7 punonjës nga shtimi i vendeve të punës.
- 50 Institucione publike të cilët do kenë një shërbim më të mirë të pastrimit dhe mjedise më të pastër.

Përfituesit indirekt të projektit janë:

- Shtate NjQV të rrethit Pukë si dhe vizitor vendas dhe të huaj, të cilët përfitojnë një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm në zonën e Pukës dhe aksin rrugorë Gomsiqe – Fushë Arrës.

Vlera e projektit

14,000 € Bashkia Pukë

56.000 € DLDP

Mënyra e organizimit të prokurimit

Procedurë e hapur në rrugë elektronike

Periudha e zbatimit të projektit

6 Muaj.

Aneksi 2: Marrveshja Paraprake midis Bashkise Pukë dhe Komunave Qerret dhe Rrape për projektin "Organizimi i përbashkët ndërvendor i shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Pukë, Komunat Qerret dhe Rrape"



AKT MARREVESHJE

MIDIS

BASHKISE PUKE

DHE

KOMUNAVE QERRET E RRAPE

PER

HARTIMIN DHE ZBATIMIN E PLANIT NDERVENDORE TE MENAXHIMIT TE MBETJEVE URBANE NE BASHKINE PUKE DHE KOMUNAT QERRET E RRAPE

PUKE 25.11.201

AKT – MARREVESHJE

E lidhur sot ne date 25.11.2011 ndermjet tre njesive vendore e konkretisht Bashkise Puke dhe Komunave Qerret e Rrape, te perfaqsuar nga kryetaret respektiv z. Beqir Arifaj, Rrok Doda e Ndue Gjoni, per hartimin dhe zbatimin e planit ndervendore te menaxhimit te mbetjeve urbane ne Bashkine Puke, Komunat Qerret dhe Rrape.
Baza ligjore: Neniu 10 pika 3, germa "f" te ligjit nr.8652, date 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar me ligjin nr.9208, date 18.03.2004; ne ligjin nr.8934, date 05.09.2002 "Per mbrojtjen e rajodisit", i ndryshuar me ligjin nr. 9890, date 20.03.2008 dhe ligjin 9983, date 08.09.2008; Ligjin nr.9537, date 18.05.2006 "Per menaxhimin e mbetjeve te rrezikshme"; ne ligjin nr. 8094, date 21.03.1996 "Per largimin publik te mbetjeve".

Neni 1
Objekti i akt marreveshjes

Bashkia Puke , Komunat Qerret dhe Rape me vullnetin e tyre te lire bien dakort qe te nenshkruajne kete akt marreveshje bashkepunimi ndervendore per hartimin dhe zbatimin e planit ndervendore te menaxhimit te mbetjeve urbane ne territoret e tyre ne administrim. Kjo akt marreveshje pas hartimit te planit ndervendore te menaxhimit te mbetjeve urbane, pranimin nga DLDP ja per financim e nenshkrimin e kontrates, do te pasohet me nje marreveshje tjeter per zbatimin e ketij plani.

Neni 2
Detyrimet e tre njesive vendore (Paleve)

1.Menjehere palet me urdherat perkatese te kryetareve te NQV, ngrejne grupet e punes per hartimin e project propozimit sipa sformatit tip per aplikim te fazes pare dhe paraqesin dokumentacionin perkates ne zyrat e DLDP-se per konkurrim, me date 30.11.2011. Ne perberje te grupeve te punes do jene specialistet e NQV te cilet kane punuar dhe jane trainuar per shkrimin e project propozimeve per financim me donator te huaj.

2.Me miratimin e kualifikimn e metejshem te project propozimit nga gruper e punes fillon shkrimi i plote i project propozimit, grumbullimi i dokumentacionit shoqerues e dorezimi ne Zyrat e DLDP per konkurrim, me

date 01.02.2012.Grupet e punes duhet te marrin pjese ne trainimet qe do te organizohen nga DLDP-ja.

3.Ne rast prauimi te projektit per financim nga DLDP –ja e cila shoqerohet me nenshkrim kontrate nga palet dhe DLDP, administratat vendore dhe grupet e punes do angazhohen totalisht per zbatimin e projektit me te gjitha detyrimet te pereaktuar ne kete akt – marreveshje dhe ne akt marreveshjen e cila do nenshkruhet per zbatimin e projektit.

4. Tre njesite vendore do te mbulojne shpenzimet e sherbimit te pastrimit ne territorin qe administrojne dhe evadimin e mbetjeve dhe konkretisht.

a.Komunat Qerret dhe Rrape do financojne shpenzimet e pastrimit ne territorin qe adminstrojne dhe shpenzimet e karburantit per transportimin e mbetjeve dhe mirembajtjen e investimeve kapitale ne perdorim.

b.Bashkia Puke do mbuloje te gjitha shpenzimet e tjera per evadimin e mbetjeve urbane nga territori i tre komunave me makine teknologjike, per ne vend depozitimin e mbetjeve ne Fush Qarri.

c.Bashkia Puke merr persiper bashkefinancimin per projektin ne shumen e 20% te vleres se projektit ose 14.000 Euro.

d.Palet bien dakort qe me perfundimin e projektit skema ndervendore e menaxhimit te mbetjeve urbane te funksionoje duke e persosur me tej me skema pilot te minimizimit te mbetjeve, e grumbullimin e diferencuar e kompostimin e mbetjeve.

e.Palet bien dakort qe me perfundimin e projektit te planifikojne ne buxhetet vjetore te tyre fonde per majtje e qendrushmerine e projektit e te investimeve te perbashketa.

f.Palet bien dakort qe te vazhdojne rregullisht trainimin e stafeve te tyre, ne djetim te menaxhimit te mbetjeve urbane.

Neni 3
Lideri

Duke e mbeshtetur ne eksperiencen e duhur qe ka bashkia Puke ne menaxhimin e mbetjeve urbane, stafin e pregatitur, ndermarrjen perkatese te ngritur te bashkise per kete sherbim, infrastrukturen, buxhin vjetor te

miratuar dhe pagesen e beshkefinancimin ne masen 20% te projektit, palet bien dakord qe lider ne perfaqsim per tre NQV te jete Bashkia Puke.

Neni 4
Komunikimi

Gjithe komunikimet ne lidhje me kete marreveshje duhet te jene me shkrim ne adrese te tre njesive vendore.

Neni 5
Zgjidhja e mosmarreveshjes

Ne rast mosmarreveshje ne lidhje me interpretimin dhe ekzekutimin e planit ndervendore te menaxhimit te mbetjeve urbane, pas perfundimit te projektit, palet do ti zgjidhin ato me mirekuptim, ne rast te kundert palet do t'i drejtohen Gjykates se Rrethit Gjyqesor.

Neni 6
Te ndryshme

Kontrata hyn ne fuqi ne momentin e nenshkrimit te saj nga palet.

KOMUNA QERRET	KOMUNA RRAPE	BASHKIA PUKE
KRYETARI	KRYETARI	KRYETARI
Rrok DODAJ	**Ndue GJONI**	**Beqir AIRFAJ**

MARRËVESHJE

MES NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE, PËR ZBATIMIN E PLANIT NDËRVENDOR TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Sot më datë _____2012, në qytetin e Pukës, arrihet kjo Marrëveshje mes njësive të qeverisjes vendore Bashkia Pukë, Komuna Qerret dhe Komuna Rrape, të trija të përfshira në Rrethin e Pukës, Qarku Shkodër, secila e përfaqësuar rregullisht nga Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore:

(i) Bashkia Pukë e përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. Beqir Arifaj;

(ii) Komuna Qerret e përfaqësuar nga Kryetari i komunës z. Rrok Dodaj;

(iii) Komuna Rrapë e përfaqësuar nga Kryetari i komunës z. Ndue Gjoni.

Njësitë e qeverisjes vendore të përmendura më sipër dhe palë të kësaj Marrëveshje,

- ☐ Duke synuar promovimin e veprimtarive të përbashkëta dhe të qendrueshme në interes të komunitetit, qytetarëve dhe biznese që banojnë dhe/ose zhvillojnë veprimtarinë sociale dhe/ose ekonomike brenda territorit të tyre;
- ☐ Duke qenë të ndërgjegjshëm për rëndësinë e bashkëveprimit dhe bashkëpunimit në fusha me interes të përbashkët, brenda funksioneve të veta të njësive të qeverisjes vendore si dhe duke synuar shtrirjen e bashkëpunimit në kohë dhe në territor, sipas rastit deri në nivel rrethi apo edhe qarku;
- ☐ Duke qenë të angazhuar për shfrytëzimin maksimal të mundësive për gjenerimin e fondeve dhe mbështetjen e aktiviteteve të përbashkëta si një mundësi e mirë për arritjen e suksesit në përmbushjen e funksioneve të qeverisjes vendore;
- ☐ Duke vlerësuar me përgjegjshmëri detyrimet individuale dhe të përbashkëta që burojnë nga ligji për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore dhe akteve nënligjore në zbatim të tij dhe/ose legjislacionit tjetër në fuqi që lidhet me detyrimet e njësive të qeverisjes vendore;
- ☐ Duke konsideruar të sukseshëm dhe duke vlerësuar suksesin e procesit të aplikimit të projektit të përbashkët për realizimin e pastrimit dhe evadimit të mbetjeve urbane, dhe duke siguruar financim nga DLDP;
- ☐ Duke konsideruar të vlefshme Marrëveshjet e mëparshme të arritura mes tyre në referim të realizimit të qëllimit të kësaj Marrëveshjeje dhe në veçanti të Marrëveshjes së datës 25.11.2011 "Për hartimin dhe zbatimin e planit ndërvendor të menaxhimit të mbetjeve urbane në territoret e tyre në administrim" (më specifikisht të përcaktimeve të nenit 1 të Marrëveshjes);

vendosin bashkërisht termat e mëposhtëm dhe angazhohen në përmbushjen e tyre me përgjegjshmëri dhe në respekt të ndërsjelltë ndaj njëra tjetrës.

Neni 1 Qëllimi i Marrëveshjes

1.1. Qëllimi i kësaj Marrëveshje është përcaktimi i rregullave të cilat do të zbatohen nga palët gjatë zbatimit të përbashkët të planit ndërvendor të menaxhimit të mbetjeve për mbledhjen dhe evadimin e mbetjeve urbane në territorin në administrim të palëve.

1.2. Në objektin e Marrëveshjes hyjnë grumbullimi dhe evadimi i mbetjeve urbane në dhe nga pikat e grumbullimit të përcaktuar në territoret e njësive vendore palë të kësaj marrëveshjeje dhe që transportohen nga makina teknologjike.

Neni 2 Përkufizime

1.1. "Palë" do të quhet sipas kontekstit, secila nga tri njësitë e qeverisjes vendore që hyjnë në këtë Marrëveshje apo të trija njësitë e qeverisjes vendore së bashku.

1.2. "Bashkia Pukë" është njësia e qeverisjes vendore e cila ka në administrim pjesën e territorit të Republikës së Shqipërisë të përcaktuar në _____.

1.3. "Komuna Qerret" është njësia e qeverisjes vendore e cila ka në administrim pjesën e territorit të Republikës së Shqipërisë të përcaktuar në _____.

1.4. "Komuna Rrape" është njësia e qeverisjes vendore e cila ka në administrim pjesën e territorit të Republikës së Shqipërisë të përcaktuar në _____.

1.5. "Njësia lider" është Bashkia Pukë si autoritet i qeverisjes vendore dhe palë e kësaj kontrate.

1.6. "DLDP" është Decentralization and Local Development Programme

1.7. "Fondi i kontingjencës" është fondi në dispozicion të njësisë së qeverisjes vendore, i cili përdoret në raste të veçanta, sipas përcaktimeve në ligjin për qeverisjen vendore.

1.8. "Dokumenti i Specifikimeve Teknike" (DST) është Dokumenti që i bashkëlidhet kësaj Marrëveshje dhe që përbën pjesë integrale të saj, në të cilin përcaktohen specifikimet teknike që lidhen me të gjitha aspektet e realizimit të menaxhimit të përbashkët të mbetjeve.

1.9. "Grupi i punës" është grupi i përbashkët i ngritur nga njësitë e qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve në këtë Marrëveshje.

1.10. "Projekti" nënkupton planin ndërvendor të përbashkët për menaxhimin e mbetjeve urbane.

1.11.

Neni 3 Përfaqësuesit e palëve

1.1. Përfaqësuesit e palëve në këtë Marrëveshje janë autoritetet kompetente ekzekutive dhe/ose vendimarrëse në secilën prej njësive të qeverisjes vendore, të cilat nënshkruajnë dhe/ose lëshojnë autorizimet përkatëse për nënshkrim, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke e bërë këtë Marrëveshje të detyrueshme për zbatim.

Neni 4 Delegimi i funksioneve

1.1. Për efekt të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, palët do të konsiderojnë se kanë deleguar tek "Njësia lider" funksionin e mbledhjes dhe heqjes së mbeturinave, për sa parashikuar në këtë Marrëveshje dhe/ose në planin ndërvendor të menaxhimit të mbetjeve.

1.2. Çdo njësi e qeverisjes vendore palë e kësaj Marrëveshjeje siguron marrjen e vendimeve të nevojshme dhe të domosdoshme për bërjen efektive të kësaj Marrëveshjeje, në kuptim të ushtrimit të funksioneve të veta të qeverisjes vendore dhe brenda afateve të kërkuara nga zbatimi i projektit.

Neni 5 Afati i zbatimit të Marrëveshjes

1.1. Rregullat e përcaktuara në këtë Marrëveshje do të fillojnë të zbatohen nga palët menjëherë pas përfundimit të procedurave të tenderimit të makinerive dhe vendosjes së kazanëve sipas DMM, por jo më vonë se data _____.

Neni 6 Grupi i Punës

1.1. Grupi i punës për ndjekjen e zbatimit të Marrëveshjes ngrihet me urdhër të përbashkët të Kryetarëve të njësive vendore palë të kësaj Marrëveshje. Grupi i Punës mund të jetë ngritur para datës së miratimit të Marrëveshjes dhe me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje palët konfirmojnë grupin e punës si strukturë koordinuese dhe raportuese.

1.2. Anëtarët e Grupit të punës përfaqësojnë njësinë vendore përkatëse.

1.3. Detyrat e anëtarëve grupit të punës përfshijnë:

(i) Përfaqësimin e palëve;

(ii) Raportimin periodik në organet e qeverisjes vendore lidhur me zbatimin e Marrëveshjes;

(iii) Raportimin periodik në Grupin e punës lidhur me çështjet e ngritura nga palët e Marrëveshjes mbi zbatimin e saj;

(iv) Kryerjen e detyrave të tjera të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

1.4. Ndryshimi i anëtarëve të Grupit të Punës bëhet me Urdhër të përbashkët të Kryetarëve të njësive vendore palë të kësaj Marrëveshje, ose mund të bëhet me urdhër të Kryetarit të Njësisë Vendore palë e kësaj Marrëveshje, për anëtarin përfaqësues përkatës, me kusht që Urdhri ti bëhet

me dije zyrtarisht palëve të tjera të Marrëveshjes, jo më vonë se 2 ditë pune nga dalja e tij.

Neni 7 Makineritë dhe pajisjet teknike

1.1. Sigurimi i makinerive dhe pajisjeve për zbatimin e planit ndërvendor për menaxhimin e mbetjeve bëhet fillimisht me mbështetjen financiare të DLDP, nëpërmjet procedurave të prokurimit sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

1.2. Pronësia e pajisjeve mbetet e Bashkisë Pukë, përveç kontenierëve të vendosur në territorin e secilës palë, sipas përcaktimeve në DST, të cilët mbeten në pronësi të palës përkatëse.

1.3. Sasia dhe çështje të tjera të karakterit teknik që lidhen me makineritë dhe pajisjet janë përcaktuar në DMM.

Neni 8 Strukturat e angazhuara

1.1. Për përmbushjen e detyrave që rrjedhin nga kjo Marrëveshje dhe kryerjen e grumbullimit dhe evadimit të mbetjeve, përveç sa parashikuar për Grupin e Punës, Bashkia Pukë angazhon strukturat e veta, përgjegjëse për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane.

Neni 9 Itineraret e lëvizjes së makinës teknologjike

1.1. Itinerari i lëvizjeve së makinës teknologjike për realizimin e grumbullimit të mbetjeve urbane do të jetë:

(i) Bashkia Pukë – Rrape;

(ii) Rrape – Pukë;

(iii) Pukë – Qafë Qerret;

(iv) Qafë Qerret - kryqëzimi i shkollës Qerret;

(v) kryqëzimi i shkollës Qerret – Kçirë;

(vi) Kçirë - Luf Qendër;

(vii) Luf Qendër – Gomsiqe;

(viii) Gomsiqe - Vend depozitimi në Fushë Qarr.

1.2. Itinerari i lëvizjes së makinës teknologjike mund të ndryshojë në varësi të skemës që mund të përcaktojë grupi i punës, pas monitorimit të ecurisë së projektit. Grupi i punës përfshin çdo ndryshim të skemës në raportimin që i bëhet palëve të Marrëveshjes.

Neni 10 Shpeshtësia e itinerareve

1.1. Itinerari i lëvizjes së makinës teknologjike kryhet çdo ditë të hënë, të mërkure dhe të premte, në përputhje me parametrat e përcaktuar në

DST.

1.2. Shpeshtësia e kryerjes së Itinerarit të lëvizjes së makinës teknologjike mund të ndryshojë në varësi të skemës që mund të përcaktojë grupi i punës, pas monitorimit të ecurisë së projektit. Grupi i punës përfshin çdo ndryshim në raportimin që i bëhet palëve të Marrëveshjes.

Neni 11 Kosto e projektit

1.1. Për efekt të zbatimit të Marrëveshjes dhe përmbushjes së projektit, në kosto të projektit do të llogariten:

(i) Kosto mirëmbajtje e pikave të grumbullimit;

(ii) Kosto amortizimi e makinës teknologjike;

(iii) Kosto karburanti për makinën teknologjike;

(iv) Kosto lubrifikanti për makinën teknologjike.

1.2. Kostot përllogariten në bazë të itinearit dhe shpeshtësisë së itinerarëve për çdo njësi vendore, duke iu referuar kritereve dhe normativave të përcaktuara në DST.

1.3. Në kostot e projektit nuk futet asnjë shpenzim tjetër për zëra të cilat mund të parashikohen nga Bashkia Pukë për përmbushjen e funksioneve të veta për pastrim gjelbërim në territorin e saj.

Neni 12 Pjesëmarrja në projekt (përqindja)

1.1. Pjesëmarrja në projekt, në kuptim të termave financiarë, nga secila njësi e qeverisjes vendore palë e kësaj Marrëveshje, përcaktohet në bazë të përfitimit të palës përkatëse.

1.2. Mënyra e përllogaritjes së pjesëmarrjes është përcaktuar në DST. Kontributi financiar në vlerë është i lidhur me koston e projektit.

1.3. Pjesëmarrja në përqindje në projekt e palëve të Marrëveshjes është:

(i) Bashkia Pukë 77% (shtatëdhjetë e shtatë përqind);

(ii) Komuna Qerret 14% (katërmbëdhjetë përqind);

(iii) Komuna Rrape 9% (nëntë përqind)

1.4. Pjesëmarrja në përqindje mbetet e pandryshuar, pavarësisht ndryshimit të kostos së projektit. Pjesëmarrja në përqindje mund të ndryshojë vetëm me një Marrëveshje të re mes palëve, për arsye të ndryshimit të termave të përcaktuar në DST.

1.5. Kontributi në vlerë monetare për vitin e parë të zbatimit të projektit është sipas përcaktimit në DST.

Neni 13 Rillogaritja vjetore e kostos

1.1. Rillogaritja e kostos bëhet çdo vit përpara hartimit të buxhetit të njësive të qeverisjes vendore.

1.2. Grupi i punës është përgjegjës për rillogaritjen vjetore të kostos së projektit dhe raportimin tek palët e Kësaj Marrëveshjeje.

Neni 14 Parashikimi në buxhet i kostos së projektit

1.1 Palët e kësaj Marrëveshjeje janë të detyruara të parashikojnë vlerat e projektit, të cilat duhet të mbulohen sipas përqindjeve të pjesëmarrjes në projekt dhe kostove të llogaritura, në buxhetin përkatës vjetor të secilës njësi vendore.

Neni 15 Pagesat për koston e projektit

1.1 Pagesat për koston e projektit bëhen nga njësitë vendore Rrapë dhe Qerret në favor të Bashkisë Pukë.

1.2 Pagesat kryhen brenda vitit buxhetor.

Neni 16 Vjelja e tarifave

1.1. Palët e kësaj Marrëveshje angazhohen për krijimin e një skeme të qartë dhe transparente për caktimin dhe vjeljen e tarifës së pastrimit në territorin përkatës. Palët mund të informojnë njëra tjetrën lidhur me funksionimin e skemës.

1.2. Skema për caktimin dhe vjeljen e tarifës vendore të pastrimit merr në konsideratë përcaktimet e bëra në DST.

Neni 17 Mbulimi i kostove (në rast të mosmbledhjes së tarifave).

1.1. Në rastet kur një palë e kësaj Marrëveshje nuk është në gjendje të mbulojë kostot e projektit, për shkak të mosmbledhjes së tarifës vendore, atëherë kostot do të mbulohen nga fondi i kontingjencës.

Neni 18 Mos kryerja e pagesave

1.1. Moskryerja e pagesave për mbulimin e kostos së projektit sjell si pasojë ndërprerjen e shërbimit.

1.2. Në rastet e moskryerjes së pagesave, pala e dëmtuar e Marrëveshjes ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmeve që janë rrjedhojë e moskryerjes së pagesave.

Neni 19 Raportimi

1.1. Grupi i punës raporton në mënyrë periodike në organet e qeverisjes vendore. Raportimi duhet të përfshijë në mënyrë të detajuar:

(i) çdo veprimtari që zhvillohet në kuadër të projektit të përbashkët;

(ii) afatet që janë përcaktuar për realizimin e veprimtarive të projektit;

(iii) shpenzimet e kryera për realizimin e veprimtarive të projektit;

(iv) kostot që lindin gjatë zbatimit të projektit;

(v) diskutimet që bëhen në grupin e punës;

(vi) çështjet që duhen trajtuar nga organet e qeverisjes vendore.

Neni 20 Publiciteti

1.1. Bashkia Pukë merr përsipër që me shpenzimet e veta të realizojë publicitetin e rastit të bashkëpunimit të sanksionuar nga kjo Marrëveshje, duke synuar zgjerimin e projektit dhe futjen e njësive të tjera të qeverisjes vendore me qëllim arritjen e uljeve të mëtejshme të kostos së projektit

Neni 21 Zgjerimi i projektit

1.1. Zgjerimi i projektit, duke lejuar hyrjen e njësive të tjera të qeverisjes vendore bëhet nëse palët bien dakord. Në këtë rast hartohet një Marrëveshje e re, e cila nënshkruhet nga palët e kësaj Marrëveshjeje si dhe njësia/njësitë e qeverisjes vendore që do të përfshihen në projekt.

Neni 22 Të fundit

1.1. Kjo Marrëveshje nënshkruhet në 5 kopje.

1.2. Marrëveshja bëhet e vlefshme pasi të ketë marrë të gjitha miratimet e kërkuara nga legjislacioni për organizimin e dhe funksionimin e qeverisjes vendore.

BASHKIA PUKË **PËRFAQËSUAR NGA** **KRYETARI I BASHKISË** **Z. BEQIR ARIFAJ**	**KOMUNA QERRET** **PËRFAQËSUAR NGA** **KRYETARI I KO-MUNËS** **Z. RROK DODAJ**	**KOMUNA RRAPE** **PËRFAQËSUAR NGA** **KRYETARI I KO-MUNËS** **Z. NDUE GJONI**